



Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës

RAPORT I PUNËS

AKTIVITETI NË SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE	2
Aktiviteti: Përmbledhje e aktiviteteve dhe implementimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020	2
Aktiviteti: Reformat në vlerësimin e studentëve	5
Aktiviteti: Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë	9
Aktiviteti: Pranimi i studentëve në FM	10
Aktiviteti: Rishikimi i rregullores për avancime dhe databazat e rekomanduara për publikime shkencore të stafit të Fakultetit të Mjekësisë	11
Aktiviteti: Zgjedhja dhe avancimi i stafit akademik në FM	13
Aktiviteti: Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë	15
Aktiviteti: Fillimi i funksionalizimit të Qendrës Informative të Barnave (QIB)	22
Aktiviteti: Funksionalizimi i Qendrës për Simulim dhe Zhvillim të Shkathtësive Klinike	23
Aktiviteti: Aplikimi i teknologjive të reja në procesin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në FM	25
Aktiviteti: Puna kërkimore shkencore	28
Aktiviteti: Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimorë	29
Aktiviteti: Përpilimi i raporteve F1, F2, F3	30
Aktiviteti: Aktivitetet tjera përbrenda Universitetit të Prishtinës	31
AKTIVITETI NË SFERËN PROFESIONALE SHËNDETËSORE	33
Aktiviteti: Takime pune me Drejtorin ekzekutiv të SHSKUK-se dhe Bordin e SHSKUK	34
Aktiviteti: Organizimi i edukimit të vazhdueshëm profesional nga Fakulteti i Mjekësisë	34
AKTIVITETI NË SFERËN E INFRASTRUKTURËS DHE FINANCAVE	35
Buxheti i ndarë për Fakultetin e Mjekësisë - 2018	35
Shpenzimet e Fakultetit të Mjekësisë sipas kategorive	39

AKTIVITETI NË SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE

Aktiviteti: Përmbledhje e aktiviteteve dhe implementimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020

Gjatë vitit 2018, Menaxhmenti i Fakultetit të Mjekësisë, intensifikoi aktivitetet e fokusuar rreth implementimit të Strategjisë Zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë. Përveq vazhdimit të konsolidimit të rezultateve të arritura gjatë vitit 2016 dhe 2017, gjatë vitit 2018 menaxhmenti i FM-së, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë shefat e degëve dhe katedrave të FM-së, u fokusua në arritjen dhe plotësimin e këtyre aspekteve të strategjisë zhvillimore:

- Përmirësimin a nevojave kadrovike të FM-së;
- Modernizimin dhe ngritjen e interaktivitetit në procesin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në FM;
- Përmirësimin e infrastrukturës, inventarit dhe furnizimit me pajisje të nevojshme për mbarëvajtjen dhe ngritjen e cilësisë në mësimdhënje dhe mësimnxënje;
- Përmirësimin e vlerësimit të studentëve dhe integritetit të vlerësimeve dhe
- Intensifikimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtarë.

Strategjia në fjalë ishte përpiluar me marrjen e detyres nga menaxhmenti i tanishëm, në vitin 2016. Kjo strategji është prezantuar para partnerëve ndërkombëtarë dhe ka marrë edhe vlerësime të larta.



Faculty of Medicine
University of Prishtina

DEVELOPMENT STRATEGY

2016-2020

Executive Summary



Gjatë vitit 2018, menaxhmenti i FM-së i pësoi edhe disa ndryshme. Në këtë aspekt, për shkak të fitimit të burses Fulbright Scholar, program i State Departmentit-it që në Kosovë administrohet nga Ambasada Amerike, Prodekani për Çështje Akademike Prof Asoc Dr Kreshnik Hoti, udhëtoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht Massachusetts Institute of Technology (MIT), për të realizuar projektin përkatës kërkimorë shkencorë. Me këtë rast, ky post u zëvendësua nga Prof Asoc Dr Sefedin Muçaj, Prodekan për Çështje Akademike.

Rezultatet e implementimit të strategjisë zhvillimore të FM gjatë vitit 2018:

- *Ngritja e kapaciteteve kadrovike në FM;*
- *Inicimi i formimit të zyrës së vlerësimeve si pjesë e strategjisë së FM për të avancuar dhe përmirësuar integritetin e procesit të vlerësimit të studentëve;*
- *Ngritja substanciale në interaktivitetin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në fushën e anatomisë, embriologjisë, radiologjisë, fiziologjisë patologjike dhe anatomisë patologjike nëpërmjet aplikimit të teknologjisë më të avancuar;*
- *Vazhdimi i pranimit të studentëve në baza meritore dhe duke respektuar në plotësi kriteret e përcaktuara*
- *Përmirësimi i infrastrukturës në FM gjatë vitit 2018, sidomos në aspektin e mësimdhënjes*
- *Vazhdimi i ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Mjekësisë*
- *Funksionalizimi i Qendrës për Simulim dhe Zhvillim të Aftësive Klinike, qendër kjo e krijuar nga FM në vitin 2017*
- *Mbështetja dhe angazhimi në ngritjen e punës kërkimore në FM sidomos në aspektin e zgjerimit të kontakteve me partnerë rajonal dhe ndërkombëtarë*
- *Bashkëpunimi me organizata profesionale me qëllim të rritjes së mundësive të studentëve tonë për të kryer punë praktike profesionale;*
- *Adresimi i kërkesave të katedrave në raport me përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik në realizimin e mësimin dhe punës kërkimore;*
- *Përmirësimi i infrastrukturës;*
- *Përmirësimi i furnizimit të pajisjeve laboratorike;*
- *Përmirësimi i furnizimit të mjeteve të IT*

Aktiviteti: Reformat në vlerësimin e studentëve

Përshkrimi i aktivitetit:

a) Inicimi i themelimit të zyrës së vlerësimeve

Në vazhden e aktiviteteve për ngritjen e cilësisë së vlerësimit të studentëve në FM, si dhe në ngritjen e përgjithshme të integritetit akademik, FM në bashkëpunim me zyren e Prorektorit për Cilësi, ishte i suksesshëm në fitimin e projektit nga Ambasada Amerikane, në lidhje me sjelljen e një Fulbright specialistit në Fakultetin tonë për të filluar iniciimin e themelimit të zyrës së vlerësimeve në FM. Adresimi i vlerësimit të studentëve dhe përmirësimi i këtij procesi është në linjë me strategjinë zhvillimore të FM.



Në Fakultetin e Mjekësisë për herë të parë është organizuar një vizitë pune e një specialisti Fulbright Prof. Shane Desselle nga SHBA me qëllim të inicimit të themelimit të Qendrës për Vlerësime në FM të UPHP.

Vlerësimi i studentëve në FM dhe në Universitetin e Prishtinës (UP) në përgjithësi, ka nevojë për avancim të mëtutjeshëm dhe reformizim. Për shembull, studentët në UP zakonisht avancojnë në vitet vijuese pa mbaruar plotësisht provimet e vitit paraprak. Kjo ndikon negativisht në procesin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes. Mëtutjue, si rezultat i kësaj, studentët në UP janë nën stres të vazhdueshëm dhe kërkojnë vlerësime shtesë gjatë javëve mësimore të studentëve. Kjo ndikon negativisht edhe në procesin e mësimdhënjes. Sistemi dhe politikat e tanishme të vlerësimit të studentëve kontribuojnë në këtë situatë.

Gjithashtu, ky proces ndikon edhe në shkallën e përfundimit të studimeve nga ana e studentëve duke rezultuar kështu në numra të paparashikueshëm të studentëve nëpër vitet përkatëse akademike të programeve studimore. Prandaj, si pjesë e reformës së vlerësimeve, duhet të ngritet vetëdija në lidhje me relevancën e sistemit të vlerësimit të studentëve.

Duke konsideruar këtë, FM planifikoi të bëhet pionier në UP për të filluar themelimin e zyrës së vlerësimeve me qëllim të avancimit të procesit të vlerësimeve, promovimin e mësimnxënjes nga ana e studentëve dhe për të siguruar avancim të integritetit akademik të vlerësimeve.

Projekti “Advancing the process of student assessments”, mbështetur nga Ambasada Amerikane, është dizajnuar të stimulojë dhe mbështesë çështjen e avancimit të vlerësimit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Universitetin e Prishtinës rrjedhimisht.

Objektivat kyqë të projektit të mësipërm ishin:

- Themelimi i një pilot zyreje të vlerësimeve në FM, modeli i të cilit do të aplikohet edhe në njësitë tjera të UP-së;
- Rishikimi dhe ofrimi i udhëzimit në lidhje me reformimin dhe avancimin e procedurave dhe politikave të vlerësimit të studentëve;
- Trajnimi i stafit në lidhje me politikën e vlerësimit të studentëve me fokus në analizën e rezultateve dhe raportimit, notimin dhe moderimin, vlerësimin e vazhdueshëm dhe integritetin akademik të vlerësimit të studentëve.

Për më shumë detaje rreth inicimit të zyrës për vlerësimin e studentëve dhe raportin nga ky projekt, shih shtojcën A.



Momente nga trajnimi i stafit të FM-së nga Prof Shane Desselle, në lidhje me vlerësimin e studentëve, në kuadër të projektit të FM-së



Momente nga trajnimi i menaxhmentit të UP-së në lidhje me themelimin e qendrës së vlerësimeve, në kuadër të projektit të FM-së

b) Zbatimi i rubrikave e vlerësimit

Gjatë gjithë vitit 2018, vazhdoi zbatimi me sukses i vlerësimit të temave të diplomës. Këto vlerësime u realizuan nga komisionet përkatëse me rastin e mbrojtjes së temës së diplomës nga ana e kandidatëve. Rubrikat e vlerësimit të studentëve u dizajnuan gjatë vitit 2017 në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e cilësisë në punën që dorëzohet nga studentët.

Me rastin e auditimit të mbrojtjes së temave të diplomës, është konstatuar që si rrjedhojë e procedurave të dizajnuara, asnjë nga studentët nuk ka mbrojtur temën e diplomës pa ju nënshtruar procesit të vlerësimit sipas standardeve të parapara me formularët e vlerësimit dhe rubrikat e vlerësimit të studentëve.

Sqarim: Rubrika e vlerësimit është një instrument i dizajnuar nga Komisioni i Studimeve i Fakultetit të Mjekësisë. Kjo rubrikë është dizajnuar me qëllim të përcaktimit të kriterëve themelore gjatë vlerësimit të studentëve me rastin e prezantimit të punës së tyre seminarike apo me rastin e mbrojtjes së temave të diplomës. Ky sistem mundëson vendosjen e vlerës numerike në raport me përshkruesit specifik të performancës së studentëve dhe mundëson një llogaritje më objektive të poentimit dhe notimit të studentëve gjatë prezantimit të punës së tyre. Duke siguruar një uniformitet dhe standard ndërmjet vlerësuesve të ndryshëm të të njejtit student, rubrika e vlerësimit gjithashtu ndikon pozitivisht në aspektin e mbrojtjes së integritetit akademik gjatë procesit të vlerësimit të studentëve (shih shtojcën e bashkangjitur).

b) Vlerësimi i vazhdueshëm i studentëve dhe aplikimi i syllabuseve

Gjatë vitit akademik 2017/2018, kanë vazhduar me intensitet të shtuar aktivitetet rreth zbatimit të vlerësimit të vazhdueshëm në Fakultetin e Mjekësisë. Në rastet kur syllabuset e lëndëve përkatëse nuk e kanë paraparë vlerësimin e vazhdueshëm atëherë nga Profesorët i kanë përditësuar ato për të përfshijë komponentet e vlerësimit të vazhdueshëm gjatë vitit akademik. Duhet theksuar se një gje e tillë është paraparë edhe me rekomandimet e Agjencise së Akredimitit dhe në përgjithësi nga rekomandimet që ndërlidhen me cilësinë në arsimin e lartë.

c) Zbatimi i formularëve të vlerësimit

Gjatë vitit akademik 2017/2018 ka vazhduar implementimi i formularëve të vlerësimit të studentëve nga ana e profesorëve. Gjatë vitit akademik, Dekanati ka organizuar auditime të randomizuara në lidhje me zbatueshmërinë e aplikimit të formulareve të vlerësimit.

Me rastin e auditimit të katedrave përkatëse, është konstatuar që ende ka nevojë që stafit ti ngritet vetëdija rreth aplikimit të formularit të vlerësimit dhe mbajtjes së atij formulari në dispozicion për auditim. Presim që gjatë vitit akademik 2018/2019, komplainca në aspektin e përdorimit të formulareve të vlerësimit të jetë e plotë.

Aktiviteti: Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Gjatë vitit 2018, Fakulteti i Mjekësisë ka vazhduar aktivitetet rreth fokusit në akreditimin e programit të mamsisë në FM. Në këtë aspekt, vlen të theksohet se tani FM ka në dispozicion gjeneratën e parë të të diplomuarve në programin Edukimi në Kujdesin Shëndetësorë-MSc, dhe rrjedhimisht kjo do të ndikojë pozitivisht në mundësinë e akreditimit të programit të mamsisë në FM. Duhet theksuar se FM ka të akredituara programet si Mjekësi e Përgjithshme (deri në vitin 2021), Fizioterapi (deri në vitin 2019), Stomatologji (deri në vitin 2021), Farmaci (deri në vitin 2021), Infermieri (deri në vitin 2019), Mjekësi Praktike -PhD (deri në vitin 2021), Mjekësi Klinike-PhD (deri në vitin 2021), Stomatologji-PhD (deri në vitin 2021), Shëndet Publik-PhD (deri në vitin 2021) dhe Biomjekësi Eksperimentale (deri në vitin 2021); si dhe programi Edukimi në Kujdesin Shëndetësorë-MSc (deri në vitin 2020).

Aktiviteti: *Pranimi i studentëve në FM*

Përshkrimi i aktivitetit: Për vitin akademik 2018/2019, Fakulteti i Mjekësisë ka përmbyllur me sukses procesin e regjistrimit të studentëve në nivelin e studimeve themelore, studimeve master dhe studimeve të doktoratës. Pranimi i studentëve, proces ky i cili historikisht ka kaluar nëpër faza të vështira në FM, edhe këtë vit është përfunduar me sukses nga ana e menaxhmentit të FM, duke respektuar në përpikshmëri udhëzimet dhe konkursin e shpallur nga Rektorati, si dhe duke respektuar rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Kjo ka vazhduar të kontribuoj pozitivisht në ngritjen dhe ruajtjen e kredibilitetit të FM në këtë proces. Kësaj here, kryetar i komisionit për pranimin e studentëve në studimet themelore ishte Prof Ass Dr Fatmir Dragidella.



Ekipi punues pas përfundimit të provimit pranues të afatit të parë (karantina 24 orë).

Në aspektin e realizimit të provimeve pranuese për studentët e vitit akademik 2018/2019 në FM, vlen të theksohen edhe faktet si në vijim:

- Provimi pranues për studentë të rregullt për vitin akademik 2018-2019, u monitorua nga organizata ORCA.
- Janë pranuar 310 studentë në pesë drejtime të ndryshme.
- Eshtë menaxhuar me sukses poashtu, provimi pranues i afatit të dytë. Në këtë afat janë pranuar 110 studentë në pesë drejtime të ndryshme.
- Është organizuar provimi pranues për studentë të nivelit master dhe janë pranuar 32 studentë
- Janë organizuar dy provime pranuese për studentë të nivelit të doktoratës, në të cilat janë pranuar 31+22=53 studentë.
- Menaxhimi i përgatitjes për riakreditim të programit bachelor të Mamisë dhe të doktoratës për farmaci.

Aktiviteti: *Rishikimi i rregullores për avancime dhe databazat e rekomanduara për publikime shkencore të stafit të Fakultetit të Mjekësisë*

Fakulteti i Mjekësisë dha kontributin e vet në lidhje me rishikimin e rregullores për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik në UP. Në këtë aspekt, Këshilli Mësimorë-Shkencorë i Fakultetit të Mjekësisë propozoi që për stafin akademik të Fakultetit të Mjekësisë të vlejnjë databazat: Eeb of Science, Pubmed, Scopus dhe Scimago (që bazohet në Scopus). Këto databaza morën aprovimin unanimit të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë.

Gjithashtu, në kuadër të rregullores së re për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik në FM, me iniciativën e menaxhmentit të FM-së, Këshilli Drejtues i UP-së aprovoi propozimin që në rastin e Fakultetit të Mjekësisë, të njihen orët klinike në kuadër të rishqyrtimit të pozitave për konkurs. Në këtë aspekt, për lëndët klinike u aprovua që orët klinike të mësimdhënjes (pra nga mësimi klinik) të llogariten në kuadër të plotësimit të normës për ligjerata. Në rastet kur pozita e re nuk mund të plotësohet me 50% e normës së plotë me ligjerata, atëherë në kuadër të normës të llogaritet dyfishi i orëve gjatë mësimdhënjes në lëndën e Praktikës Klinike të vitit 6, pra në raport 2:1. Kërkësa e FM drejtuar KD, ishte arsyetuar me faktin që kemi mjaft klinika të QKUK-së pa profesorë, janë pensionuar shumë

profesorë që nuk janë zëvendësuar, ngritja e cilësisë së mësimdhënjes në lëmi specialitike të profilizuara të cilat për momentin nuk kanë profesorë si dhe efekteve të përgjithshme pozitive që kjo do të ketë në QKUK dhe shëndetësinë kosovare në përgjithësi.

Na vazhdën e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijës në lidhje me mungesat kadrovike në FM, Fakulteti i Mjekësisë organizoi Tryezë të Rrumbullakët me titull: “Krizë e ekzistencës së Klinikave të QKUK-së si pasojë e mungesës së profesorëve”, në të cilën morrën pjesë Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Bytyqi, Ministri i Shëndetësisë z. Ismaili, Këshilltari i Kryeministrit, Dr. Jaha, Kryesuesja e Këshillit Drejtues të UP-së z. Bunjaku, Rektori i UP-së Prof. Dema, Kryesuesi i Bordit të SHSKUK-së, Prof. Ramadani dhe Drejtori ekzekutiv i SHSKUK-së Dr. Sejdiu. Parakrisht u organizuan takime të veçanta me Kryetarin e Kuvendit z. Veseli, Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z. Bytyqin dhe Ministrin e Shëndetësisë z. Ismailin lidhur me këtë çështje.



Detaje nga tryeza e rrumbullakët e organizuar nga FM dhe kryesuar nga Dekanja e FM

Gjithashtu vlen të theksohet se në kuadër të rregullores për zgjedhje dhe avancim të stafit akademik, dhe për të adresuar problemin e katedrave paraklinike dhe shqetësimet e ngritura nga shefat e ketyre katedrave në aspektin kadrovik, u aprovua edhe propozimi i Këshillit të FM-së që në lëndët paraklinike specializimi nuk është i domosdoshëm. Nëqoftëse kandidati që konkuron në lëndët paraklinike ka specializim atëherë vlerësimi i atij specializimi të bëhet në pajtueshmëri me specializimet e përafërta të përcaktuara nga katedra përkatëse paraklinike dhe në harmoni me kërkesat e katedrës përkatëse.

Aktiviteti: Zgjedhja dhe avancimi i stafit akademik në FM

Në kuadër të adresimit të strategjisë zhvillimore të FM-së, synim qëndror është edhe ngritja e kapaciteteve të mësimdhënjes. Në këtë aspekt, vlenë të theksohet se gjatë dekadave të fundit, stafi i FM-së nuk është përtrirë në raport me nevojat si dhe në raport me stafin e pensionuar. Kjo ka ndikuar në nevojën për shumë angazhime dhe shfrytëzim të stafit ekzistues për të mbajtur orë mbinormë. Duke konsideruar këto aspekte, katedrat e FM-së, me kërkesë të Dekanatit, rishikuan orët në dispozicion për stafin akademik në përpikshmëri. Rrjedhimisht, katedrat bënë kërkesat e tyre kadrovike në Dekanat. Kështu u bë menaxhimi i suksesshëm i konkursit për staf akademik të rregullt. Në këtë konkurs ishin 63 pozita nga të cilat 27 për avancime zgjedhje, rizgjedhje të stafit ekzistues; 16 për avancim nga pozita asistent në profesor asistent, 10 pozita për avancim të asistentëve pas vendimit të Këshillit Drejtues dhe 10 pozita të reja.

Menaxhmenti i FM-së synon të mirëmbajë transparencën në procesin e zgjedhjes së stafit akademik duke përfshirë këtu edhe sigurimin e përzgjedhjes së stafit në baza meritore. Kjo do të ndikojë pozitivisht në ndërtimin e mëtutjeshëm të reputacioni të Fakultetit të Mjekësisë si dhe ngritjes së kapaciteteve kadrovike në FM. Në këtë aspekt, FM ia arriti që ndieshëm të ngrisë kapacitetet kadrovike të FM-së dhe:

FM për herë të parë që nga themelimi i tij pranoi në një konkurs 25 Profesorë asistentë të rinj, nga të cilët 18 femra.

Gjithashtu, vlen të theksohet se procesi i zgjedhjes së stafit të angazhuar akademik në Fakultetin e Mjekësisë për vitin akademik 2018-2019 është përmbyllur me sukses. Në kuadër të konkursit për angazhimin e bashkëpunetorëve të jashtëm, janë pranuar 76 bashkëpunëtorë të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime.



Në fotot e mësipërme shihet menaxhmenti i FM-së me stafin e ri akademik të avancuar apo zgjedhur

Aktiviteti: Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë

Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë është një nga prioritetet kyçe të menaxhmentit të FM. Kjo është specifikuar edhe në strategjinë zhvillimore të Fakultetit. Në këtë aspekt, menaxhmenti i ri ka realizuar këto aktivitete konkrete:

Angazhimi në ngritjen e punës kërkimore në FM duke krijuar fillimisht databazën e tërë

aktivitetit kërkimor në FM, si dhe inicimi i bashkëpunimit me “Geisel School of Medicine at

Dartmouth” për përfshirjen e stafit në projektet e tyre hulumtuese

Vizitë në Fakultetin e Mjekësisë të Dartmouth College, Dartmouth Hitchcock Medical Center dhe Norris Cotton Cancer Center, me të cilët kemi bashkëpunim që nga paslufta, si në aspekt të shkëmbimit të studenteve ashtu edhe të stafit për trajnime profesionale.

Qëllimi i vizitës është diskutuar mbi mundësinë e zgjerimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme sidomos në onkologji (kujdesin paliativ) dhe fillimin e disa projekteve të përbashkëta siq është roli i HPV në zhvillimin e kancerit të qafës së mitrës, kancer regjistrin e Kosovës etj., për të cilat është diskutuar gjatë konferencave të organizuara me skype dhe kërkohet që të vazhdohet me takime zyrtare edhe me lidërsipin e këtyre qendrave dhe të fakultetit.



Pjesëmarrja në Forumin shkencor për hulumtime shkencore ndërkombëtarë për Europën Juglindore bazuar në një memorandum bashkëpunimi të nënshkruar ndërmjet Ministrave të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të shteteve të Europës Juglindore, të cilët kanë themeluar të ashtuquajturin Instituti “Shkenca për Paqë”.

Një nga topikat kryesore ishte “Hadron Terapia” për trajtim të kancerit që ka filluar të përdoret vetëm në Gjermani dhe Japoni, si një teknologji shumë e sofistikuar për trajtim shumë preciz të kancerit.

Komisioni Evropian, desku për shkencë është i interesuar që të bëhen hulumtime shkencore në Europe lidhur me "hadron terapinë" duke involvuar shkencëtarë të rinj edhe nga vendet e ndryshme të Europës Juglindore, me qëllim të fitimit të rezultateve të reja lidhur me këtë lloj trajtimi shumë të sofistikuar për kancerin. Konferenca u zhvillua në Trieste të Italisë më 25 dhe 26 Janar 2018.



Vizitë Fakultetit të Mjekësisë të "Basque Country University" në Bilbao të Spanjës me qëllim të inicimit të bashkëpunimit ndërmjet dy fakulteteve/universiteteve në kuadër të programit Erasmus+.




Vizitë pune në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Podgoricës me rastin e ceremonisë së 20 vjetorit të themelimit të tij



Pjesëmarrja në konferencën e organizuar nga Liga Evropiane për Kancer sëbashku me Komisionin Evropian dhe Shoqatën Gjermane të kancerit ku u prezantua poashtu puna e Bordit Nacional Kosovar për Kontroll të Kancerit në Nëntor 2018.



Vizitë e delegacionit të Universitetit të Prishtinës në Universitetin Yildiz në Stamboll të Turqisë





Vizitë pune e Dekanit, Prof. Dr. Xheladin Draçini me zv.Rektoren dhe profesorë të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë të Tiranës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës si dhe organizimi i një konference të përbashkët me temë: “Insuficiencia kardiake”.



Vizitë pune e Dekanit, Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha dhe Prodekaneve të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tetovës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës



Pjesëmarrja aktive në kongresin e 30të Evropian të Patologjisë në Spanjë



Prezantimi i projektit “Kujdesi paliativ në Kosovë” i realizuar nga studentët e Dartmouth College dhe Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve si dhe me Bordin Nacional për Kontroll të Kancerit të Kosovës



Aktiviteti: *Fillimi i funksionalizimit të Qendrës Informative të Barnave (QIB)*

Siq është cekur edhe në raportet e kaluara, Fakulteti i Mjekësisë ka marrë iniciatiën e themelimit të Qendrës Informative të Barnave (QIB). Kjo është e para QIB në Kosovë dhe misioni parësorë i kësaj qendreje është që të sigurohet përdorimi racional i barnave, minimizimi i problemeve nga barnat dhe reduktimi i pranimeve në spital që janë rezultat i përdorimit jo të drejtë të barnave. Gjatë vitit 2018, në kuadër të realizimit të këtij projekti me interes nacional, Dekanati ka realizuar këto aktivitete:

- ka funksionalizuar zyren dhe lokacionin për stafin akademik të degës së Farmacisë në kuadër të QIB-së;
- ka realizuar takime të ndryshme dhe është koordinuar me SHSKUK-në në lidhje themelimin e QIB;
- ka vazhduar komunikimin me QIB tjera në Amerikë dhe Gjermani, për të bashkëpunuar në aspektin e ngritjes së kapaciteteve të QIB-së.

Aktiviteti: *Funksionalizimi i Qendrës për Simulim dhe Zhvillim të Shkathtësive Klinike*

Në Janar të vitit 2018, Fakultetit Mjekësisë themeloi qendrën për simulim dhe zhvillim të shkathtësive klinike – qendër e parë e këtij lloji në Kosovë. Kjo qendër u themelua me fonde vetanake të UP-së. Gjatë tërë vitit 2018, ka vazhduar funksionalizimi dhe shfrytëzimi me sukses i kësaj qendrije, duke ju ofruar kështu studentëve të FM-së një përvojë të veçantë në procesin e mësimnxënjes. Qëllimet e themelimit të kësaj qendrije, duke u bazuar edhe në strategjinë e zhvillimit të FM-së, janë që të përmirësohet mësimdhënja dhe mësimnxënja e shkathtësive klinike duke simuluar ambiente reale, që u mundeson studentëve të ushtrojnë teknika të ndryshme klinike në modele trupore (mullazhe), para se ata të angazhohen në praktikën klinike me pacientë të vërtetë.

Nga shfrytëzimi i vazhdueshëm dhe avancimi i mëtutjeshëm i kësaj qendrije, në presim përmirësim të performancës së studentëve dhe reduktim të ankthit të studentëve para se ata të praktikojnë në pacientë të vërtetë; Studentët arrijnë një nivel të kënaqshëm të konfidencës dhe profiqiencës bazike para punës dhe procedurave me pacientë real; Përmirësim i sigurisë së pacientëve dhe mirëqenjes së tyre; Mbushja e zbrazëtirës ndërmjet mësimin teorik dhe praktikës klinike

Në kuadër të kësaj qendrije, studentët ushtrojnë teknika të ndryshme klinike në modele trupore (mullazhe), para se ata të angazhohen në praktikën klinike me pacientë të vërtetë. Qendër e parë e këtij lloji në Kosovë. Kjo është hera e parë që studentët e Fakultetit të Mjekësisë do të fillojnë të mësojnë në ambient të realitetit të simuluar

Fotot më poshtë janë nga funksionalizimi dhe shfrytëzimi i Qendrës për Simulim dhe Zhvillim të Aftësive Klinike nga ana e studentëve të FM-së



Aktiviteti: Aplikimi i teknologjive të reja në procesin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në FM

Siq është specifikuar në strategjinë zhvillimore të FM-së 2016-2020, FM synon që të ngritet në një qendër të edukimit mjekësorë e cila ofron klasë botëore të edukimit mjekësorë. Në këtë aspekt, përdorimi i teknologjive të reja, brenda kushteve tona, mbetet objektivë kyqë e menaxhmentit të FM-së.

a) E-laboratori

Gjatë vitit 2018, FM ka vazhduar që me sukses të shfrytëzojë e-laboratorin, qendër kjo e dizajnuar nga FM për të ngritur kyqjen e teknologjisë informative në procesin e edukimit shëndetësorë që ofron FM. Gjatë vitit 2018 janë organizuar takime të ndryshme me shefa të katedrave që për qëllim kanë pasur ngritjen e vetëdijës së stafit akademik në lidhje me mundësitë që ofron e-laboratori. Rrjedhimisht, stafi akademik i FM-së ka realizuar një mori aktivitësh si telekonferencat dhe ligjeratat nga distanca.

b) Digjitalizimi

Gjatë vitit 2018, vazhdoi aplikimi i gjërë i:

- google-drive me qëllim të organizimit më të mirë të katedrave të FM, duke përfshirë edhe raportimin e tyre në sistem 'real-time',
- formularëve të ndryshëm elektronik për raportim dhe monitorim të mësimit
- kartelat identifikuese të ligjeratave

Gjithashtu, zyra e prodekanit për çështje akademike në bashkëpunim me koordinatoren për cilësi, gjithashtu ka bërë digjitalizimin e planprogrameve të FM duke krijuar kështu QR kodet e planprogrameve të ndryshme me qëllim të lehtësimit të proceseve administrative. Më poshtë janë paraqitur shembujt e QR kodeve specifike të FM-së.



QR kodet e planprogrameve të ndryshme të FM-së

c) Teknologjitë e reja

Gjatë vitit 2018, FM ka arritur të zgjerojë përdorimin e teknologjisë për qëllime edukative në FM. Në këtë aspekt, është bërë aplikimi i teknologjive të reja për mësimdhënje dhe hulumtim shkencor dhe Digjitalizimi i edukimit mjekësor në vecanti anatomi, embriologji, radiologji, anatomi patologjike.



Fragmente nga sjellja dhe përdorimi pajisjeve të reja teknologjike në FM

Aktiviteti: *Puna kërkimore shkencore*

Përshkrimi i aktivitetit:

